

Zhvillohet Bllok 1 i Programit për Auditimin e Performancës organizuar nga SNAO

Sarajevë, 1-4 prill 2025

Nga data 1-4 prill 2025 u zhvillua në Sarajevë, blloku i parë i Programit të Trajnimit për Auditimin e Performancës, i organizuar nga Zyra Suedeze e Auditimit (SNAO). Qëllimi i këtij programi është ofrimi i një trajnimi të strukturuar për të ndihmuar në ndërtimin e një rrjeti profesional të auditimit të performancës, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Pjesëmarrës në këtë trajnim janë grupe audituesish të rinj nga Institucione Supreme të Auditimit të Shqipërisë, Kosovës, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Moldavisë, Gjeorgjisë dhe Ukrainës. KLSH në këtë program merr pjesë me auditimin e performancës “*Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit*” me pjesëmarrjen e auditueseve Annavanessa Hoxhaj dhe Lorena Liçi.

Trajnimi u fokusua në trajtimin e bazave të auditimit të performancës, duke përfshirë parimet dhe metodologjinë, si dhe dallimet midis auditimit të performancës, atij financiar dhe të



përputhshmërisë. Pjesëmarrësit dhanë opinionet e tyre mbi standardet e auditimit në sektorin publik dhe ndryshimet midis auditimit të performancës, auditimit financiar dhe auditimit të përputhshmërisë.

U trajtuan më tej “teoria e ndryshimit” dhe “logjika e ndërhyrjes”, dy koncepte thelbësore për analizën e problemeve dhe hartimin e auditimeve të performancës, ku u diskutua lidhja dhe rëndësia e problemeve sociale në kontekstin e auditimit të performancës.

U vijua me konceptin e “3E-ve” (Efektivitet, Efëncë dhe Ekonomi) dhe modelin “input-output”, ku audituesit morën pjesë në ushtrime praktike për të kuptuar dhe aplikuar këto koncepte në auditim, ashtu si dhe u trajtua koncepti i pemës së problemit. Grupet punuan për të ndërtuar pemën e problemeve mbi temat e zgjedhura të auditimit, duke identifikuar shkaqet dhe pasojat e mundshme të problemeve të performancës që ata do të auditojnë.

Në përfundim, grupet e auditimit, trajtuan pyetjet e auditimit dhe kriteret, punuan ushtrime praktike, si dhe diskutuan mbi realizimin e pritshmërive. Blloqet e ardhshme të trajnimit do të zhvillohen në formë on-line në datat 28-30 prill dhe më pas, me takimin fizik, në datat 23-27 qershor 2025 në Shkup. Gjatë kësaj periudhe, grupet do të punojnë mbi detyrat e caktuara dhe do të plotësojnë në vazhdimësi platformën e dedikuar për këtë program trajnimi.